



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 03.08.2018

Ref.: 858/180

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 58-të, të mbajtur më 23 korrik 2018, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli":
 - Trafiku Ajror dhe Transporti, BA, 180 ECTS,
 - Logjistika dhe Transporti, BA, 180 ECTS,
 - Inxhinieri Postare dhe Telekomunikacioni, BA, 180 ECTS,
 - Trafiku Hekurudhor dhe Transporti, BA, 180 ECTS, dhe
 - Transport dhe Telekomunikacion, MA, 120 ECTS.
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (tash e tutje UA për Akreditim), neni 21 dhe 26, pika 5.3.4, Agjencia e Kosovës për Akreditim (tash e tutje AKA) me datë 23 maj 2018 ka kërkuar nga të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (tash e tutje IAL) që ti dorëzojnë listat e stafit akademik për secilin program të studimit. Në afatin e përcaktuar nga AKA, BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" ka dorëzuar listat e kërkuara nga AKA për programet e studimit.

Bazuar në të dhënat e prezantuara nga ky IAL, për programet e studimit: Trafiku Ajror dhe Transporti, BA, 180 ECTS, Logjistika dhe Transporti, BA, 180 ECTS, Inxhinieri Postare dhe Telekomunikacioni, BA, 180 ECTS, Trafiku Hekurudhor dhe Transporti, BA, 180 ECTS, (sipas kërkesës së AKA-së datë 23.05.2018) konfirmohet se për këto programe të studimit BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" nuk ka staf akademik të fushës së studimit që kërkohet sipas UA për Akreditim.

Për programin e studimit Transport dhe Telekomunikacion, MA, 120 ECTS, BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" si bartës të këtij programi ka prezantuar: Mevlan Qaflehi dhe Midin Bojaxhiu. Pas shqyrtimit të bërë të dosjes së këtyre personave, dhe pas marrjes së konfirmimit nga Administrata Tatimore e Kosovës, u konfirmua që të dy bartësit e programit të studimit Transport dhe Telekomunikacion, MA, 120 ECTS, kanë marrëdhënie të rregullt të punës në sektorin publik, pasi që në raportin e ATK-së figuron që të dy marrin pagë primare nga Ministria e Financave e Kosovës. Përveç kësaj, asnjëri nga bartësit e fushës nuk i përkasin fushës së studimit të këtij programi. Mevlan Qaflehi është Dr.sc. në Inxhinieri Fizike, ndërsa Midin Bojaxhiu është Dr.sc. në Gjeoshkenca dhe Mjedis.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 kërkohet që: "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD (Dr.sc.) apo titull të barasvlershëm artistik nga fusha e programit të studimeve". Pra siç mund të shihet nga sa u tha me sipër, kërkohet që për çdo 60 ECTS, IAL duhet të ketë një person në marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore Dr.sc., dhe të jetë i fushës së programit të studimit.

Sipas nenit 26, pika 5.3.17 e UA për Akreditim: "Një anëtar i stafit akademik që është i punësuar me orar të plotë (40 orë në javë) në një institucion të arsimit të lartë mund të kryejë detyra në institucione tjera të akredituara me më së shumti 10 orë angazhim në ligjërata, ushtrime ose mentorim të kandidatëve, që nënkupton gjysmën e normës së plotë prej 20 orë pune". Nga kjo konfirmohet që stafi akademik nuk mund të ketë në të njëjtën kohë në dy marrëdhënie të rregullta të punës. Mbi këtë bazë KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në nenin 21, pika 1 e UA për Akreditim (9/2017), thuhet se: "AKA e rezervon të drejtën të monitoroj dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim". Ndërsa sipas pikës 2 të nenit 26 të UA për Akreditim thuhet: "AKA mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/ apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur". Bazuar në këtë çka u tha me sipër dhe në mungesë të stafit akademik për programet e cekura në pikën një të këtij vendimi, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

